



Udhëzimi 6

Shtator 2016

Prokurimi publik

Shpallja

PËRMBAJTJA

- [Pse është e rëndësishme shpallja?](#)
- [Ku bëhet shpallja?](#)
- [Kur ka nevojë të bëhet shpallje?](#)
- [Mbajtja e tregut të informuar](#)
- [Shpallja e Njoftimit të Kontratës, mos publikimi dhe ndryshimet e njoftimeve të kontratës](#)
- [Dhënia e kontratës fituese](#)
- [Dhënia e kontratës kur ajo ndryshohet gjatë afatit të saj](#)
- [Si e dërgoni një njoftim dhe sa shpejt botohet ai?](#)
- [Shërbimet](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

Pse është e rëndësishme shpallja?

Shpallja është një nga gurët e themelit të prokurimit publik. Shpallje e plotë dhe e hapur:

- **lehtëson konkurrencën e duhur** - duke i informuar sa më shumë operatorë ekonomik që të jetë e mundur në lidhje me mundësitë e kontratës dhe, në këtë mënyrë, duke u mundësuar atyre që të konkurrojnë, gjë e cila çon në rezultatet më të mira të vlerës së parasë për autoritetet kontraktore;
- **zhvillon tregjet** - duke u treguar operatorëve të mundshëm ekonomikë që janë në dispozicion mundësitë për biznes, gjë e cila inkurajon zhvillimin e tregut me operatorë të rinj dhe më të larmishëm ekonomik dhe zgjeron burimin e operatorëve ekonomikë në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- **ndihmon në luftën kundër korrupsionit** - duke rritur transparencën dhe duke siguruar që operatorët ekonomikë, publikun, shtypin dhe aktorët tjerë janë të vetëdijshëm për mundësitë e disponueshme të kontratave dhe janë në gjendje që të mësojnë më shumë rreth këtyre mundësive dhe rreth operatorëve ekonomik, të cilëve u janë dhënë kontratat.

Ku bëhet shpallja?

Njoftimet për kontratat e një lloji dhe vlere të caktuar, të cilat janë subjekt i Direktivës, duhet të shpallen në Aneksin e *Gazetës Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE)*. Njoftimet publikohen nga Zyra Publikimeve të Bashkimit Evropian pa pagesë. Në internet është i disponueshëm një version i lirë i Suplementit të GZBE-së, i quajtur Ofertat Elektronike Ditore (TED).¹

Shumë Shtete Anëtare të BE-së kërkojnë shpallje, në nivel kombëtar, të njoftimeve për kontrata që nuk janë subjekt i kërkesës për t'u shpallur në GZBE.

Publikime të tjera: Mundësitë për kontratë mund të shpallen në botimet e tjera ndërkombëtare, kombëtare ose lokale. Ku përdoren shpallja shtesë, Direktiva përcakton se kjo shpallje nuk duhet të publikohet para se të jetë publikuar njoftimi i kontratës në GZBE. Megjithatë, shpallja shtesë mund të publikohet në nivel kombëtar, në rast se autoritetet kontraktore nuk janë njoftuar nga Zyra Publikimeve të Bashkimit Evropian për publikimin në GZBE brenda 48 orëve të konfirmimit të marrjes së njoftimit. Shpalljet shtesë nuk duhet të përmbajnë asnjë informacion që nuk është përfshirë në njoftimin e kontratës që është bërë në GZBE.

Kur ka nevojë të bëhet shpallje?

Nevoja për të bërë shpallje ekziston në tre raste kryesore:

- Para fillimit të procesit formal të prokurimit - një shpallje fakultative, për të paralajmëruar tregun për mundësitë potenciale në të ardhmen, duke përdorur Njoftimin Paraprak të Informacionit (NPI);
- Në fillim të procesit të prokurimit të kontratës specifike – për të ftuar operatorët ekonomikë të marrin pjesë në procesin e prokurimit, duke përdorur Njoftimin e Kontratës;
- Në fund të një procesi të prokurimit të kontratës specifike – për të njoftuar operatorët ekonomik dhe të tjerët që procesi i prokurimit ka përfunduar, duke përdorur Njoftimin e Shpalljes së Kontratës Fituese ose Njoftimin Vullnetar *ex ante* të Transparencës.

Shpalljet para fillimit të procesit formal të prokurimit duke përdorur NPI-në: Direktiva lejon, por nuk e detyron, autoritetin kontraktues që të paralajmërojë tregun për mundësitë potenciale të kontratave në të ardhmen me anë të shpalljes duke përdorur NPI-në. NPI-ja publikohet nga Zyra e Publikimeve të BE-së në GZBE ose nga autoritetet kontraktore në profilet e tyre të blerësve (shih më poshtë për më shumë informacion në lidhje me "profilet e blerësve").

¹ <http://ted.europa.eu>

Shpallja paraprakisht në këtë mënyrë siguron përfitime si për autoritetin kontraktues ashtu edhe për operatorët ekonomik të mundshëm, si më poshtë:

- Para se të bëjë shpalljen, autoriteti kontraktues duhet të ketë menduar me kujdes për kërkesat e tij, dhe kështu përgatitja e NPI-së mund të ndihmojë për të siguruar që planifikimi paraprak dhe buxheti janë marrë seriozisht.
- Operatorët ekonomik që u është bërë paralajmërim paraprak për mundësitë potenciale mund të bëjnë planifikimin në përputhje me rrethanat. Ky planifikim ndihmon në sigurimin e niveleve të mira të konkurrencës dhe të rezultate më të mira në aspektin e vlerës së parasë për autoritetin kontraktues.
- Nëse përdoret një NPI, atëherë afatet kohore ligjore të tenderit mund të reduktohen në rrethana të caktuara.
- Ndryshe nga autoritetet qendrore kontraktore, autoritetet kontraktore të mund të përdorin NPI-në si një ftesë për konkurrim, por vetëm në procedurat e kufizuara ose në procedurat konkurruese me negociim. Në këtë rast, në qoftë se NPI-ja është mjaft i detajuar, atëherë autoritetet kontraktore nuk janë të detyruara të publikojnë më vonë një njoftim të veçantë kontratës.

Formati standard i NPI-së publikohet nga Komisioni Evropian në faqen e tij² (Formulari numër 1). Format i është njëjtë për të gjitha llojet e kontratave.

Mbajtja e tregut të informuar

Si një alternativë ndaj shpalljes së një NPI-je në *GZBE*, autoriteti kontraktues mund ta mbajë tregun e informuar për mundësitë potenciale në të ardhmen duke krijuar "profilin e blerësit" të vet në internet. Profili i blerësit përmban informacion të përgjithshëm për autoritetin kontraktues së bashku me informacionin në lidhje me ftesat e vazhdueshme për tender, blerjet e planifikuara, kontratat e lidhura, dhe procedurat e anuluar.

Autoriteti kontraktues mund të përdorë profilin e tij të blerësit për të publikuar një NPI. Kur autoriteti kontraktues e përdor vetë profilin e tij blerësit për të publikuar një NPI, ai nuk ka nevojë ta dërgojë NPI-në në *GZBE*, por ai duhet të dërgojë në *GZBE* një njoftim në lidhje me publikimin e bërë në profilin e blerësit.

Shpallja në fillim të një procesi të prokurimit të kontratës specifike duke përdorur njoftimin e kontratës

Njoftimi i kontratës është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit të prokurimit. Kjo shënon fillimin e procesit formal të prokurimit për një kontratë të caktuar dhe njofton operatorët e mundshëm ekonomikë për mundësinë për të marrë pjesë në këtë proces.

Duhet të përdoren njoftimet e formatit standard. Këto njoftime publikohen nga Komisioni Evropian në faqen e tij. Format i standard i Njoftimit të Kontratës përdoret për shumicën e proceseve të prokurimit, ndërkohë që për lloje të ndryshme të prokurimit përdoren formate të ndryshme. Për shembull, për konkurset e projektimit, koncesionet e punëve publike, koncesionet e shërbimeve, dhe për shërbimet sociale dhe shërbime të tjera të veçanta do të përdoren forma të veçanta të njoftimit të kontratës.

Për të siguruar sa më shumë konkurrencë që të jetë e mundur dhe, në përputhje me kërkesat themelore për transparencë, njoftimi i kontratës duhet të hartohet në mënyrë të tillë që të përshkruajë qartë natyrën, qëllimin dhe vlerën e llogaritur të kontratës dhe të shpjegojë se si mund të aplikojnë operatorët ekonomikë për të marrë pjesë në proces. Njoftimi i kontratës duhet të realizohet në mënyrë të plotë dhe korrekte. Hartimi i një Njoftimi të Kontratës që nuk është i qartë, i plotë dhe nuk në përputhje me rregullat mund të rezultojë në një nivel zhgënjyes konkurrence, cilësi

²

www.simap.europa.eu

të dobët ose oferta të papërshtatshme, ose në një proces prokurimi me të meta që mund të duhet të rifillohet përsëri.

Cilat janë pasojat e dhënies së një kontrate publike të mbuluar nga Direktiva pa shpalljen paraprake të njoftimit të kontratës?

Direktiva lejon, në një numër të kufizuar rastesh, dhënien e një kontrate publike të mbuluar nga Direktiva pa shpalljen paraprake të njoftimit të kontratës, për shembull, ku punët, furnizimet apo shërbimet mund të sigurohen vetëm nga një operator ekonomik i caktuar ose kur është e domosdoshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje që kanë qenë të paparashikueshme për autoritetin kontraktues. Në rast se autoriteti kontraktues ka dhënë një kontratë pa shpallje paraprake në *GZBE*, pa bazë ligjore për mungesën e shpalljes, atëherë një kontratë e tillë duhet të konsiderohet e pavlefshme nga organi shqyrtues, në bazë të dispozitave të "Direktivës së mjeteve juridike" (Direktivat 89/665/KEE dhe 92/13/KEE). Për më shumë informacion mbi pavlefshmërinë e një kontrate, shih Udhëzimin nr. 1 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Mjetet juridike*. Për të shmangur kontratat e pavlefshme, Direktiva e mjeteve juridike parashikon mekanizmin e publikimit të Njoftimit Vullnetar *ex ante* të Transparencës (Formulari numër 15) në *GZBE*.

Çfarë mund të bëhet në qoftë se Njoftimi i Kontratës është i pasaktë ose nëse informacioni në Njoftimin e Kontratës duhet të ndryshohet?

Ekziston një formular standard për të bërë ndryshime të njoftimit të kontratës, që njihet si Njoftimi i Korrigjimit. Ky formular standard i njoftimit është i disponueshëm në faqen e internetit të Komisionit Evropian (Formulari numër 14) dhe mund të përdoret për botimin e ndryshimeve në njoftimet e publikuara më parë ose për të siguruar informacion shtesë. Megjithatë, nëse korrigjimet apo modifikimet e njoftimeve çojnë në një ndryshim rrënjësor të kushteve të konkurrencës, atëherë është e nevojshme që të zgjerohen afatet kohore fillestare ose të fillojë një procedurë të re.

Shpallja në fund të një procesit të prokurimit të kontratës specifike duke përdorur njoftimin e dhënies së kontratës

Autoriteti kontraktues duhet të shpallë përfundimin e një procesi të prokurimit të kontratës specifike duke përdorur Njoftimin e dhënies së kontratës brenda 30 ditëve nga data e dhënies së kontratës.

Ky njoftim i fundit është i rëndësishëm për shkak se ai siguron transparencën e procesit, pasi operatorët ekonomikë dhe të tjerët njoftohen për përfundimin e procesit të prokurimit dhe për bazën e shpalljes së fituesit. Komisioni Evropian e përdor gjithashtu këtë informacion për të përgatitur të dhënat statistikore për nivelin dhe natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe për të monitoruar proceset e prokurimit.

Detyrimi për të shpallur Njoftimin e dhënies së kontratës zbatohet për të gjitha kontratat ku është shpallur një Njoftim Kontrate si dhe për disa kontrata të tjera ku një njoftim i tillë nuk ka qenë i shpallur.

Shpallja kur kontrata ndryshohet gjatë afatit të saj

Autoritetet kontraktore duhet të publikojnë informacione për ndryshimin e kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj. Formulari standard për këtë njoftim është i disponueshëm në faqen e internetit të Komisionit Evropian (Formulari numër 20). Ky njoftim duhet të botohet nëse:

- Modifikimi ka të bëjë me punët, shërbimet ose furnizimet shtesë që janë bërë të nevojshme dhe nuk janë përfshirë në kontratën origjinale;
- Modifikimi është shkaktuar nga rrethanat që një autoritet kontraktues i zellshëm nuk mund të kishte parashikuar dhe kur modifikimi nuk ndryshon natyrën e përgjithshme e kontratës dhe

çdo rritje e çmimit nuk është më e lartë se 50% e kontratës fillestare ose e marrëveshjes kuadër.

Ka edhe situata të tjera ku Direktiva lejon modifikimin e kontratës gjatë kohëzgjatjes së saj, ndërkohë që autoriteti kontraktues që ka ndryshuar kontratën është i detyruar të publikojë njoftimin e modifikimit në *GZBE* vetëm në dy rastet e përmendura më lart.

A ka rregulla në lidhje me mënyrën se si njoftimet duhet të dërgohen dhe sa shpejt ato duhet të publikohen?

Të gjitha njoftimet duhet të dërgohen në mënyrë elektronike në Zyrën e Publikimeve të BE-së, në përputhje me formularët standard të siguruar nga Komisioni Evropian. Në faqen e internetit të Komisionit Evropian është drejtpërdrejt i disponueshëm sistemi falas. Njoftimet duhet të publikohen brenda pesë ditëve nga dërgimi.

Formati dhe procedura për dërgimin e njoftimeve elektronike janë të disponueshme në faqen e internetit të Komisionit Evropian.

Shërbimet

Subjektet kontraktore duhet të shpallin kontratat e një lloji dhe vlere të veçantë, ndërkohë që jepet më shumë fleksibilitet për sa i përket zgjedhjes së metodës së shpalljes.

Përzgjedhja e shpalljes: Subjektet kontraktore kanë një zgjedhje të lirë në mes të pesë formave të procedurave konkurruese: procedura e hapur, procedura e kufizuar, dialogu konkurrues, procedura me negociim me ftesë paraprake për konkurrim, dhe procedura e partneritetit të inovacionit.

Subjektet kontraktore kanë fleksibilitet gjithashtu edhe në aspektin se si ato shpallin - që në legjislacionin quhet "ftesë për konkurrim". Kur realizojnë një procedurë të kufizuar ose një procedurë me negociim me ftesë paraprake për konkurrim, subjektet kontraktore mund të zgjedhin të përdorin një nga tri metodat e mëposhtme:

- Njoftimi i kontratës
- "Njoftimi orientues periodik" vjetor
- Njoftimi për ekzistencën e një sistemi kualifikimi.

Kur realizojnë një procedurë të hapur, subjektet kontraktore mund të zgjedhin që të përdorin njoftimin orientues periodik ose njoftimet e kontratës.

Njoftimet lokale: Njoftimet mund të publikohen në nivel kombëtar, rast në të cilin ato nuk duhet të përmbajnë asnjë informacion tjetër përveç se informacionit që përmban njoftimi i dërguar në Komisionin Evropian, dhe njoftimet nuk duhet të publikohen në nivel lokal para datës së publikimit në *GZBE*. Megjithatë, publikimi në nivel kombëtar mund të bëhet në rast se, brenda 48 orëve të konfirmimit të marrjes së njoftimit nga Zyra e Botimeve e BE-së, subjektet kontraktore nuk janë njoftuar për publikimin e njoftimit në *GZBE*.

Sistemet e kualifikimit: Subjektet kontraktore lejohen që të ngrenë dhe të drejtojnë sistemet e kualifikimit. Sistemi i kualifikimit është një sistem në të cilin operatorët ekonomikë që janë të interesuar që të hyjnë në kontraktim me subjektin kontraktues aplikojnë për t'u regjistruar si ofruesit e mundshëm. Më pas, subjekti kontraktues regjistron disa ose të gjithë këta operatorë ekonomikë në sistemin e tij të kualifikimit. Operatorët ekonomikë të regjistruar formojnë më pas një grup nga i cili subjekti kontraktues mund të tërheqë ata që duhet të ftohen apo ata që duhen për të negociuar kontratat.

Kur krijon një sistem kualifikimi, subjekti kontraktues përdor njoftimin që shpall ekzistencën e sistemit të kualifikimit (Formulari numër 7 në faqen e internetit të Komisionit Evropian), në të cilin ai tregon qëllimin e sistemit, si të hyhet në rregullat për funksionimin e tij, dhe periudhën e vlefshmërisë. Nëse sistemi ndërpritet, atëherë autoriteti kontraktues duhet të publikojë njoftimin e dhënies së kontratës.

Marrëveshjet kuadër: Subjektet kontraktore mund të krijojnë marrëveshje kuadër duke përdorur formularin standard të Njoftimit të Kontratës.

Sistemet dinamike të blerjes: Subjektet kontraktore lejohen që të krijojnë sistemet dinamike të blerjes për blerjet që përdoren zakonisht. Në mënyrë që të krijojnë sistemin dinamik të blerjes, autoriteti kontraktues duhet të publikojë një njoftim kontrate. Ftesat për të dorëzuar ofertat për kontratat e rregulluara nga sistemet dinamike të blerjes nuk duhet të publikohen, por ati i dërgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë pjesëmarrësve të pranuar në sistem.

Njoftimi i shpalljes së dhënies së kontratës: Subjektet kontraktore duhet të dërgojnë Njoftimin e Shpalljes së Dhënies së Kontratës në format standard në Zyrën e *GZBE*-së brenda 30 ditëve të lidhjes së një kontrate ose marrëveshjeje kuadër. Njoftimet e Shpalljes së Dhënies së Kontratës për kontratat e shpallura fituese në kuadër të marrëveshjes kuadër dhe kontratat e bazuara në sistemet dinamike të blerjes mund të grupohen dhe të dërgohen në baza tremujore, brenda 30 ditëve nga përfundimi i tremujorit përkatës.

Informacion i mëtejshëm

Botimet e SIGMA-s

Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik – Moduli E2

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

Udhëzimi i Prokurimit Publik 5, *Të kuptuarit e kufijve monetarë të BE-së*

Udhëzimi i Prokurimit Publik 11, *Mjetet e prokurimit*

Udhëzimi i Prokurimit Publik 12, *Mjetet juridike*

Udhëzimi i Prokurimit Publik 16, *Prokurimi nga shërbimet*

Udhëzimi i Prokurimit Publik 17, *Prokurimi elektronik*

Udhëzimi i Prokurimit Publik 38, *Modifikimet e kontratës*

Jurisprudenca

Jurisprudencë e zgjedhur e GJED-së: C-199/85 *Komisioni kundër Italisë*, C-24/91 *Komisioni kundër Spanjës*, C-107/92 *Komisioni kundër Italisë*, C-328/92 *Komisioni kundër Spanjës*, C-318/94 *Komisioni kundër Gjermanisë*, C-225/98 *Komisioni kundër Francës*, C-385/02 *Komisioni kundër Italisë*, C-394/02 *Komisioni kundër Greqisë*, C-126/03 *Komisioni kundër Gjermanisë*, C-21/01 dhe C-28/01 *Komisioni kundër Gjermanisë*, C-362/03 dhe C-463/03 *Strabag dhe Kostman*, C-299/08 *Komisioni kundër Francës*, C-561/12 *Nordecon dhe RambollEesti*, C 19/13 *Fastweb*

http://curia.europa.eu/jcms/jcms/j_6/